



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA**

**Emërtimi i Modulit:** INTERPRETIM KONSEKUTIV A-B dhe B-A (sipas KSHK 7, Kualifikim për të nxënit gjatë gjithë jetës 3, Programet e studimeve të formimit të vazhduar)

**Programi i Formimit të Vazhduar :** “PËRKTHIM TEKNIK, LETRAR DHE INTERPRETIM”

**Lloji i Trajnimit:** Trajnim i drejtpërdrejtë, online dhe i kombinuar

**Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime:** “Gjuha e burimit” anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht, greqisht, spanjisht, turqisht, rusisht, shqip.

“Gjuha e synuar” anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht, greqisht, spanjisht, turqisht, rusisht, shqip.

**Kohëzgjatja e programit të modulit:** 30 orë 10 orë trajnim i drejtpërdrejtë ose online (3 ditë trajnimi)

5 orë studim i literaturës, materialit përkatës

15 orë përgatitje individuale për kryerjen e detyrave

**Nr. i krediteve:** 3 ECTS

**Mënyra e zhvillimit:** Orë praktike në laboratorin e interpretimit

**PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:**

Ky modul synon t’u mundësojë interpretëve të përmirësojnë aftësitë e tyre teknike, aftësinë për të reaguar shpejt, menaxhimin e stresit dhe të presionit, duke ruajtur njëkohësisht standarde të larta etike dhe profesionale. Këto objektiva synojnë t’i bëjnë interpretët më të aftë dhe të gatshëm për t’u përshtatur në kontekste të ndryshme profesionale.

Moduli është praktik, në laborator ku të trajnuarit zhvillojnë simulime të konferencave ku vënë në praktikë aftësitë e tyre në interpretimin konsekuativ nga gjuha e huaj drejt gjuhës amëtare dhe anasjelltas. Nëpërmjet ushtrimeve të ndryshme, synohet që përfituesit të përmirësojnë aftësitë e tyre të të kuptuarit të saktë të mesazheve, të të menduarit, përpunimit logjik të tyre, marrjes së saktë të shënimeve në interpretimin konsekuativ, si dhe riformulimin e ideve të folësit.

**OBJEKTIVAT E MODULIT:**

Ky modul synon:

- Të përmirësojë teknikën e marrjes së shënimeve në interpretimin konshekuativ duke mundësuar një përkthim të qartë dhe të plotë të fjalimit;
- të përmirësojë aftësinë për të memorizuar informacionet (kujtesa afatshkurtër) duke ruajtur pikat kyçe të fjalimit, duke sjellë më pak humbje informacioni gjatë përkthimit, si dhe të përforcojë aftësitë analizuese të mesazhit;
- Të zhvillojë aftësinë për të përkthyer idetë në mënyrë të qartë, të rrjedhshme dhe pa ndryshuar kuptimin e tyre duke respektuar nuancat e fjalimit dhe sintaksën e gjuhës së synuar;
- Të menaxhojë më mirë stresin dhe presionin e kohës;
- Të zhvillojë aftësinë e përkthimit të fjalimeve të specializuara;
- Të përforcojë rëndësinë e etikës profesionale në interpretim.